

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A
DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ /08/2026

PROCESVERBAL PËR PËRCAKTIMIN E ARSYEVE PËR MOSNDARJEN E
PROCEDURËS SË PROKURIMIT NË LOTE ME OBJEKT

Objekti i prokurimit: **“Rikonstruksion i N.Stacionit Kinostudio 110/35/20kV, 1x40/50MVA”**.

Fondi Limit: 549,972,223.69 (Pesëqind e dyzet e nëntë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e dyqind e njëzet e tre presje gjashtëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

Kjo vlerë konvertohet në 5,895,951.41 euro. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë më 12.08.2026 është 93.32 lekë/euro.

Procedurë e Hapur Punë Mbi Kufirin e Lartë Monetar

I mbajtur sot në datë 12.08.2026 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës në lote, përkatësisht për procedurën e prokurimit me objekt:

“Rikonstruksion i N.Stacionit Kinostudio 110/35/20kV, 1x40/50MVA”

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

Në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse, Njësia e Prokurimit, pas analizimit të natyrës, kompleksitetit dhe ndërvarësisë teknike të punimeve që përbëjnë objektin e prokurimit **“Rikonstruksion i N. Stacionit Kinostudio 110/35/20kV, 1x40/50MVA”**, gjykon se kjo kontratë nuk është e përshtatshme për t’u ndarë në lote, për arsyet e mëposhtme:

- **Natyra e punimeve që përbëjnë objektin e prokurimit është e njëjtë dhe funksionalisht e ndërlidhur, pasi të gjitha punimet kanë si qëllim të përbashkët**

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

rikonstrukcionin dhe vënien në funksion të plotë të Nënstacionit Kinostudio 110/35/20kV, 1x40/50MVA.

- **Punimet dhe fazat e zbatimit janë të ndërruar nga pikëpamja teknike dhe funksionale** dhe nuk përbëjnë njësi të pavarura që mund të realizohen dhe të funksionojnë në mënyrë të shkëputur nga pjesët e tjera të objektit.
- Ndarja e objektit në lote do të krijonte **varësi ndërmjet kontratave të ndryshme**, duke bërë që përfundimi dhe funksionalizimi i plotë i një pjese të objektit të kushtëzohej nga përfundimi në kohë dhe në përputhje me kërkesat teknike i loteve të tjera.
- Duke qenë se bëhet fjalë për një **nënstacion elektrik 110/35/20kV**, pajisjet, instalimet, punimet ndërtimore, elektrike, mekanike, testimet, kolaudimi dhe vënia në punë duhet të realizohen në mënyrë të koordinuar dhe të integruar, në mënyrë që sistemi të përmbushë parametrat teknikë dhe të garantojë funksionimin e sigurt të tij.
- Ndarja në lote mund të sjellë **vështirësi në koordinimin e punimeve**, veçanërisht në rastin e ndërhyrjeve të njëkohshme në të njëjtin objekt dhe në zona/pajisje të lidhura teknikisht me njëra-tjetrën.
- Gjithashtu, ndarja në lote do të sillte **ndarjen e përgjegjësisë kontraktore ndërmjet operatorëve ekonomikë të ndryshëm**, duke e bërë më të vështirë përcaktimin e përgjegjësisë për problematikat që mund të lindin gjatë integritetit, testimit dhe vënies në funksion të të gjithë sistemit.
- Për më tepër, **dështimi, vonesa ose mosrealizimi i njërit prej loteve do të ndikonte drejtpërdrejt në përfundimin dhe funksionalizimin e të gjithë objektit të prokurimit**, duke cenuar realizimin e qëllimit përfundimtar të kontratës.
- Realizimi i objektit nëpërmjet **një kontrate të vetme** mundëson një koordinim më të mirë të të gjitha fazave të zbatimit, përcaktimin e qartë të përgjegjësisë së kontraktorit, kontrollin më efikas të afateve dhe cilësisë, si dhe garantimin e integritetit të plotë të të gjitha punimeve dhe pajisjeve.
- Në këto kushte, **ndarja e kontratës në lote nuk do të sillte përfitime funksionale apo teknike**, por përkundrazi do të rriste kompleksitetin e zbatimit dhe rrezikun e vonesave apo mospërputhjeve ndërmjet kontratave.

Për sa më sipër, Njësia e Prokurimit vlerëson se realizimi i objektit në një kontratë të vetme është zgjidhja më e përshtatshme dhe proporcionale, pasi garanton koordinimin dhe integritetin teknik të të gjitha punimeve, një përgjegjësi të unifikuar kontraktore dhe realizimin e plotë të qëllimit të prokurimit, konkretisht rikonstrukcionin dhe vënien në funksion të Nënstacionit Kinostudio 110/35/20kV, 1x40/50MVA. Për rrjedhojë, kontrata nuk ndahet në lote.

Nga ana tjetër referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar neni 2 prashikohet shprehimisht se:

“Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË**

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar neni 14, Operatorët ekonomikë, parashikohet shprehimisht se:

Referuar sa më sipër legjislacioni i prokurimit publik njeh gjithashtu të drejtën e shoqërive për t’u bashkuar për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

Akoma më tej, legjislacioni me ndryshimet e fundit që ka pësuar ka hequr nevojën për kontratë noteriale por vetëm paraqitjen e një kontratë bashkëpunimi ndërmjet operatorëve ekonomik, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në qarqe të ndryshme.

Mos ndarja në lote e procedurës së prokurimit, nuk e kufizon tregun, pasi kriteret e hartuara në DST janë gjithëpërfshirëse, që u jepet hapësirë dhe mundësi të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar për tu bërë pjesë e procedurës të sipërcituar.